



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:179528
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714993

C. nr. 2756/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, me gjyqtarin Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit B.K. me numër personal nga fshati Ljubinje, Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë D.Sh. dhe N.M. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilin me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja Ligjore e Komunës V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 704.28 euro, jashtë seance, me datë 21 maj 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.K. nga fshati Ljubinje, Komuna e Prizrenit, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 23.08.2020 – 31.12. 2020, në shumën prej 2.30 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 110.79 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 21.11.2022, në shumën prej 337. euro.

Në shumën e përgjithshme prej 450.09 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (23.08.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi deri në shumën e kërkuar prej 704.28 euro, përkatësisht shuma prej 4.20 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesës së paditëses, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë në shumën prej 149.45 euro, përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin nën I, **si e pabazuar**.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi B.K. nga fshati Ljubinjë, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të saj D.Sh. dhe N.M. që të dy avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 23.08.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni–Drejtoria Komunale e Arsimit, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë ONSS “Izvor” me seli në Gornje Ljubinjë Komuna e Prizrenit, ku i njëjti ka punuar dhe vazhdon të punoj. Referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, dhe asaj të datës 22.01.2021, përkatësisht nenit 35 par.10 të është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Duke pasur parasysh që e paditura konform kontratës kolektive ka patur për detyrë që paditësit për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2020, deri më 21 nëntor 2022, i takon shuma në lartësi prej 704.28 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësi nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2020 është parashkruar sipas nenit 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Në fund gjykatës i ka

propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër protokolli 24/2011-12, e datës 27.09.2011, për paditësin e lëshuar nga Komuna e Prizreni–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditë është në marrëdhënie pune tek e paditura, në ONSS “Izvor” me seli në Gornje Ljubinjje Komuna e Prizrenit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është koeficienti 4. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për vitin 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 271.55 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 2.30 euro ($421.00 \times 3.3\% = 0.54 \times 4 \text{ muaj} = 2.17 \text{ euro} + 9 \text{ ditë } 0,16 \text{ euro} = 2.30$).

- Për vitin 2021 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 110.79 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 110.79 euro ($271.55 \times 3.4\% = 9.23 \times 12$ muaj = 110.79 euro).
- Për vitin 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 271.55 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 337.00 euro ($271.55 \times 11.6\% = 31.50 \times 10$ muaj = 315.00 euro) + 21 ditë $1,05 = 22.05$.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën II, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 23.08.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën Janar 2020 deri më 22 gusht 2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 7 muaj e 9 ditë apo në shumën prej 4.20 euro, ndërsa paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 23.08.2023, në bazë të lartcekurave.

Gjykata vendosi si në pikën nën III dispozitivit, duke refuzuar kërkesën e paditësit Bajram Kasi, në shumën prej 149.45 euro, bazuar në listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës ku vërtetohet se lartësia e pagës bazë së paditësit është me koeficient 4, dhe jo siç ka kërkuar në petitum të padisë shumën prej 421 euro. Gjykata vlerëson se paga mujore e paditësit është 271.55 bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 06/4540 e datës 11.12.2023, duke marrë parasysh faktin se paditësi në bazë të kontratës së punës të dorëzuar vendin e punës që e posedon e ka kurir e jo mësimdhënës siç pretendon paditësi.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (23.08.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të tjera të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.2756/23, me datë 21 maj 2024

Gjyqtari
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.